

VENDIM
Nr.42, datë 11.4.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DARDANIA ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18, pika 1, germa “f”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.4.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “En-Ku” sh.p.k., për transferimin e licencës së shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k., konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit, sipas kërkesave të neneve 8 dhe 9 të rregullores së procedurave të licencimit, dhe shprehjen juridikisht të vullnetit të shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k. për kryerjen e ndryshimeve në licencën e lëshuar kësaj shoqërie,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.10 seria PV03P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “En-Ku” sh.p.k. dhe “Dardania Energji” sh.p.k. për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta